

Në bazë të Nenit 23 të Statutit të Shoqatës, e në pajtim me Nenin 23 të Ligjit të Shoqatave dhe Fondacioneve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016), si dhe në bazë të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, të miratuar më datë 17.10.2015, Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Shoqatës për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup, të miratuar më datë 9.4.2016, si dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Shoqatës për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup, të miratuar më datë 30.10.2016, Asambleja e Shoqatës për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup, në seancën e saj që u mbajt më datë 30 tetor 2017, miratoi tekstin e konsoliduar të këtij:

## **S T A T U T I**

**të**

### **Shoqatës për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup**

#### **I. DISPOZITAT THEMELORE**

##### **Neni 1** **- statusi -**

Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup është organizatë jofitimprurëse, jopartiake dhe joqeveritare, në të cilën anëtarësohen në bazë vullnetare qytetarë dhe individë, për të siguruar jetesë më të mirë, më cilësore dhe më dinjitoze për të gjithë njerëzit që jetojnë me HIV në Republikën e Maqedonisë, me anë të promovimit të drejtësisë sociale, demokracisë pjesëmarrëse, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, barazisë, mosdiskriminimit dhe sundimit të ligjit.

Shoqata SË BASHKU MË TË FUQISHËM u themelua si organizatë e komunitetit të njerëzve që jetojnë me HIV në Republikën e Maqedonisë, dhe mbështetësve të tyre.

##### **Neni 2** **- vizioni dhe misioni -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM niset nga vizioni për një shoqëri brenda së cilës njerëzit që jetojnë me HIV kanë një jetë dinjitoze dhe të realizuar, të çliruar nga shtrëngesat e stigmës dhe diskriminimit, dhe brenda së cilës kanë akses të papenguar në përkujdesje gjithëpërfshirëse shëndetësore,

kurim dhe terapi në lidhje me HIV, si dhe në lidhje me gjendje të tjera shëndetësore, konform arritjeve më bashkëkohore të shkencës.

SË BASHKU MË TË FUQISHËM vepron për të fuqizuar njerëzit që jetojnë me HIV si anëtarë të barabartë në shoqëri, për respektimin e dinjitetit të tyre dhe për realizimin e të drejtave të tyre të shëndetit dhe të njeriut.

SË BASHKU MË TË FUQISHËM veçanërisht përkushtohet për të siguruar akses të vazhdueshëm në terapi bashkëkohore kundër-virale dhe trajtim gjithëpërfshirës të infektimit me HIV dhe të gjendjeve që kanë apo nuk kanë të bëjnë me HIV, konform arritjeve më bashkëkohore të shkencës.

### **Neni 3**

#### **- territori dhe kuadri juridik i veprimit -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM vepron në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e veta i realizon në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe me Statutin e Shoqatës.

Shoqata ka dhe veprimtarinë ndërkombëtare.

SË BASHKU MË TË FUQISHËM është e mëvetësishme dhe e pavarur në organizimin dhe realizimin e objektivave, interesave dhe aktiviteteve të veta, e që janë përcaktuar me Statutin dhe Programin e Veprimit.

### **Neni 4**

#### **- xhiro-llogaria e Shoqatës -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM është një person i veçantë juridik, me xhiro-llogarinë e vet.

Nënshkrues të autorizuar të xhiro-llogarisë janë Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Bordi Drejtues mund të autorizojë dhe një person tjetër i cili do të jetë nënshkrues i autorizuar, në mungesë të Kryetarit ose Drejtorit Ekzekutiv.

### **Neni 5**

#### **- jofitimprurja -**

Në qoftë se në punën e SË BASHKU MË TË FUQISHËM realizohet fitimi ose ndonjë tepriçë tjetër të fondeve në fund të vitit, ato domosdo të përdoren vetëm për mbështetjen dhe realizimin e objektivave dhe veprimtarive të përcaktuara me Statutin.

### **Neni 6**

#### **- titulli dhe selia -**

Titulli i Shoqatës lexon:

Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup.

Titulli i shkurtër është: Shoqata SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup.

Titulli i Shoqatës në gjuhën anglishte lexon:  
Stronger Together, Association for Support of People Living with HIV.

Selia e SË BASHKU MË TË FUQISHËM gjendet në Shkup, në Rr. "Vasko Karajanov", nr. 2/4, 1000 Shkup, R. e Maqedonisë.

**Neni 7**  
**- vula dhe simboli -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM ka vulën e rrumbullakët, vulën drejtkëndëshe dhe logon e saj.

Vula është në formë të rrumbullakët me radius nga 4 centimetra me tekst në sfondin rrethor të vulës, i cili lexon:

Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Vula drejtkëndëshe ka formën e drejtkëndëshit, me tekst në sfondin e saj, i cili lexon:

Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me HIV - SË  
BASHKU MË TË FUQISHËM  
Nr. ---/---- (numri i regjistrit)  
----- (data)  
Shkup

Teksti që është në përmbajtjen e vulës së rrumbullakët dhe vulës drejtkëndëshe është shkruar në gjuhën maqedonishte me alfabetin e saj cirilik.

**Neni 8**  
**- gjuha -**

Puna e SË BASHKU MË TË FUQISHËM zhvillohet në gjuhën maqedonishte.

Me kërkesën e anëtarëve të caktuar të Shoqatës, të cilët janë pjesëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, aktet në komunikimin e brendshëm të SË BASHKU MË TË FUQISHËM mund të përkthehen në gjuhën dhe alfabetin të cilët përdorin këto komunitete, në pajtim me ligjin.

**Neni 9**  
**- publiciteti në punë -**

Puna e SË BASHKU MË TË FUQISHËM është me karakter publik.

Publiciteti në punë sigurohet me anë të:

- informimit të rregullt të qytetarëve rreth aktiviteteve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;

- pranisë së anëtarëve, e me ftesë të personave të tjerë të jashtëm në seancat e organeve dhe trupave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- disponueshmërisë së raporteve dhe akteve të tjera drejtuar anëtarëve dhe personave të tjerë të interesuar;
- paraqitjes në mediumet e raportimit publik;
- bashkëpunimit me organizata të tjera joqeveritare, shoqata dhe aleanca, organe dhe institucione shtetërore;
- publikimit të materialeve të shtypura, faqes vetjake në internet dhe formave të tjera të informimit elektronik.

### **Neni 10**

#### **- e drejta e bashkimit -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM mund të bashkëpunojë, të anëtarësohet dhe të lidhet me organizata të tjera joqeveritare ndërkombëtare, koalicione, aleanca, rrjete, dhe organizata të ngjashme.

## **II. OBJEKTIVAT, VEPRIMTARITË DHE PARIMET**

### **Neni 11**

#### **- objektivat -**

Shoqata SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup me veprimin e vet bën përpjekje për realizimin e objektivave të mëposhtëm specifike:

- Fuqizimi i njerëzve që jetojnë me HIV, që të mund të përballen me sfidat që sjellin aspektet shëndetësore dhe sociale të infektimit me HIV;
- Çrrënjësja e stigmës dhe diskriminimit ndaj njerëzve që jetojnë me HIV dhe atyre që në mënyrë të tjetër janë prekur nga HIV në të gjitha segmentet e jetës shoqërore;
- Sigurimi i vetëndihmës, mbështetjes së ndërsjellë, solidaritetit, kujdesit dhe mbështetjes së jashtme të personave që jetojnë me HIV, dhe të të afërmeve të tyre;
- Sigurimi i jetës cilësore dhe dinjitoze për njerëzit që jetojnë me HIV;
- Sigurimi i pjesëmarrjes më të madhe të njerëzve me HIV në zgjidhjen e të gjitha çështjeve që prekin ata, në përputhje me Parimet e Denverit të vitit 1983, me parimin ndërkombëtarisht të njohur GIPA të vitit 1994, si dhe në përputhje me traditën e përgjithshme botërore të aktivizmit të njerëzve me HIV dhe SIDA në luftën për të drejtat e njeriut, me qëllim gjetja dhe përsosja e terapive dhe kurimi, si dhe për akses universal në ato;
- Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve dhe serviseve për njerëzit që jetojnë me HIV;
- Sigurimi i aksesit të mëkohshëm dhe të vazhdueshëm në terapi bashkëkohore dhe cilësore kundër-virale dhe kurimi dhe përkujdesja

gjithëpërfshirëse shëndetësore për njerëzit që jetojnë me HIV, në pajtim me arritjet më bashkëkohore të shkencës;

- Avancimi dhe mbrojtja e të drejtave civile, shëndetësore, seksuale dhe riprodhuese, si dhe të drejtave të tjera të njeriut për njerëzit që jetojnë me HIV, në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

## **Neni 12**

### **- parimet e punës -**

Parimet themelore mbi të cilat organizohet puna dhe veprimi i SË BASHKU MË TË FUQISHËM janë:

- barazia dhe barabarësia,
- reciprociteti dhe solidariteti,
- pjesëmarrja,
- besueshmëria,
- paaanësia dhe pavarësia,
- transparenca,
- ligjshmëria në punë.

Në veprimin e saj, SË BASHKU MË TË FUQISHËM më hollësisht do të drejtohet edhe nga parimet e mëposhtme:

- Zbatimi i politikës së mundësive të barabarta, sigurimi i baraspeshës më të drejtë të mundshme dhe përfaqësimit të të gjithë njerëzve me HIV në të gjitha fushat e veprimit të saj;
- Promovimi dhe aplikimi konsekuent i parimeve të të drejtave kombëtare dhe kulturore të barazisë dhe dallimit mes të gjithë personave që jetojnë me HIV;
- Promovimi i harmonisë, bashkëpunimit, shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe informacioneve tona, puna në ekip, kultura e dialogut dhe komunikimit;
- Ruajtja e mëvetësisë dhe veprimit vetjak në përputhje me vizionin, misionin, objektivat dhe parimet tona;
- Krijimi, vendosja dhe vëzhgimi i treguesve të matshëm për monitorimin e aktiviteteve tona dhe vlerësimin e rezultateve, gjë kjo e cila do na bëjë më transparentë dhe më të përgjegjshëm si përpara anëtarëve tanë, ashtu dhe përpara komunitetit të PJHIV në RMV, autoriteteve dhe donatorëve;
- Transparenca dhe llogaridhënia, informimi i publikut rreth aktiviteteve, burimeve dhe metodave të financimit, aplikimi i ligjeve, normave ligjore pozitive dhe i standardeve dhe rregullave të tjera të brendshme dhe ndërkombëtare.

Shoqata SË BASHKU MË TË FUQISHËM njeh dhe merr parasysh nevojat specifike të personave që jetojnë me HIV, e të cilët vijnë nga nëngrupe dhe komunitete të ndryshme që janë prekur nga HIV, e sidomos gratë, burrat gej dhe biseksualë dhe burrat e tjerë që bëjnë seks me burra, personat trans, burrat heteroseksualë, si dhe pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme etnike.

Shoqata SË BASHKU MË TË FUQISHËM njeh dhe merr parasysh në punën e vet problemet dhe nevojat specifike të komunitetit të burrave gej

dhe biseksualë, si dhe të personave trans, gjegjësisht, popullsisë më të gjerë të burrave që kanë marrëdhënie seksuale me burra, si komunitet, apo popullsi, e cila joproportionalisht dhe në mënyrë mbizotëruese është prekur nga HIV në Republikën e Maqedonisë; në këtë komunitet, përkatësisht popullsi, është numri më i lartë i personave me HIV, të cilët nuk janë të vetëdijshëm për statusin e vet HIV dhe të cilët nuk kanë akses në terapi dhe përkujdesje shëndetësore.

Shoqata orvatet të sigurojë përfaqësimin përkatës të komunitetit të burrave gej dhe biseksualë dhe personave trans në administratën e vet.

### **Neni 13**

#### **- klasifikimi i veprimtarisë -**

Konform Klasifikimit Kombëtar të Veprimtarive, veprimtaria mbizotëruese e punës së Shoqatës SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup është 94.99 - Veprimtaritë e organizatave të tjera në bazë të anëtarësisht, të përmendura diku tjetër.

Lënda e punës së Shoqatës SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup është dhe veprimtaria e mëposhtme, e cila përcaktohet me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarive: 58.19 - Veprimtaritë e tjera botuese.

## **III. ANËTARËSIA. HYRJA DHE PËRJASHTIMI NGA ANËTARËSIA NË SHOQATË**

### **Neni 14**

#### **- hyrja në anëtarësi -**

Anëtar i SË BASHKU MË TË FUQISHËM mund të jetë një individ dhe qytetar, i cili ndan vizionin, misionin, objektivat dhe rregullat e punës së SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Të gjithë anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e barabarta, pavarësisht nga përkatësia e tyre racore, etnike, fetare, politike ose gjinore, statusit social, pronësor ose arsimor, përcaktimit seksual, moshës, si dhe dallimeve në çfarëdo baze tjetër.

Kandidatët për anëtarë paraqesin një fletëparaqitje tek Bordi Drejtues. Fletëparaqitjen e shqyrton Bordi Drejtues, i cili vendos për dhënien e statusit të anëtarit shoqëruar në Shoqatë. Në seancën e parë të ardhshme, Asambleja vendos për dhënien e statusit të anëtarit të plotëdrejtë.

Anëtari automatikisht humb statusin e anëtarit të plotëdrejtë, në qoftë se:

- është i punësuar në Zyrën Ekzekutive të Shoqatës, ose është i angazhuar nga Shoqata me kontratë të punës së përkohshme, e cila është ekuivalenti i orarit të shkurtuar prej 20 ose më tepër orë për javë;
- nuk merr pjesë në punën e dy seancave të njëpasnjëshme të Asamblesë.

Asambleja mund të shqyrtojë dhe të sjell vendimin për anulimin e statusit të anëtarit të plotëdrejtë dhe dhënien ose rihënien e statusit të anëtarit shoqërues.

### **Neni 15**

#### **- pushimi nga anëtarësia -**

Anëtarësia në Shoqatë pushon në rastet e mëposhtme:

Anëtarësia në Shoqatë pushon në rastet e mëposhtme:

- Me largimin vullnetar të anëtarit, duke paraqitur një deklaratë me shkrim ose në formë elektronike drejtuar Kryetarit ose Bordit Drejtues,
- Me vdekjen e anëtarit,
- Me përjashtimin e anëtarit nga Asambleja, në qoftë se anëtari vepron në kundërshtim me dispozitat e Statutit, nuk respekton ose nuk kryen vendimet e organeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM, nuk respekton parimet themelore të punës dhe veprimit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe nuk respekton programin e veprimit, prish dhe përçmon reputacionin dhe dinjitetin e SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe pengon punën e organeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Për përjashtimin nga Shoqata vendos Asambleja me shumicën e votave të pranishme, që vijon pas propozimit dhe shqyrtimit të mëhershëm.

### **Neni 16**

#### **- të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve -**

Anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- të zgjedhin dhe të zgjidhen/të votojnë dhe të jenë të votuar dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të marrin pjesë në punën e organeve dhe trupave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM, të kryejnë mbikëqyrjen e punës dhe aktiviteteve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe të kontribuojnë për zhvillimin dhe fuqizimin e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të marrin iniciativa dhe propozime për realizimin e objektivave dhe detyrave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të kontribuojnë për dispozitat e Statutit dhe aktet e organeve dhe trupave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- në kuadrin e mundësive të veta, të marrin pjesë konkrete në zbatimin e programit të veprimit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe të projekteve të përcaktuara;
- të sigurojnë kushte për funksionimin e papenguar të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- punë të tjera konform Statutit, akteve të organeve dhe trupave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe rregullave ligjore pozitive.

## **IV. ORGANET E SHOQATËS**

### **Neni 17**

#### **- organet e Shoqatës -**

Organet e SË BASHKU MË TË FUQISHËM janë:

- Asambleja,
- Kryetari,
- Bordi Drejtues,
- Drejtori Ekzekutiv.

## **V. ASAMBLEJA**

### **Neni 18**

#### **- statusi dhe përbërja e Asamblesë -**

Asambleja është organi më i lartë i SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e plotëdrejtë.

### **Neni 19**

#### **- të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve të Asamblesë -**

Përfaqësuesit e SË BASHKU MË TË FUQISHËM kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- të marrin pjesë në seancat e Asamblesë dhe të organeve të punës në të cilat janë zgjedhur;
- të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet dhe trupat e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të bëjnë mbikëqyrjen e punës së organeve të tjera të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të respektojnë dispozitat e Statutit dhe programit të veprimit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të përfaqësojnë interesat dhe qëndrimet e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të propozojnë zgjidhje të interesit të përbashkët për SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të marrin pjesë aktive në realizimin e objektivave dhe detyrave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- të drejta dhe detyrime të tjera konform akteve të organeve dhe trupave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe rregullave ligjore pozitive.

### **Neni 20**

#### **- mbajtja e seancave të Asamblesë -**

Seancën e Asamblesë thirr Kryetari i SË BASHKU MË TË FUQISHËM të paktën një herë në vit.

Seanca e Asamblesë thirret edhe me propozimi të Bordit Drejtues, ose me propozim të së paku një të tretës së numrit të anëtarëve.



Seanca e Asamblesë mund të mbahet në qoftë se të gjithë përfaqësuesit janë informuar brenda një afati të arsyeshëm dhe janë të pranishëm shumica e të gjithë përfaqësuesve.

### **Neni 21**

#### **- mënyra e marrjes së vendimeve të Asamblesë -**

Me rregull, Asambleja merr vendimet me shumicën e votave të përfaqësuesve të pranishëm (shumica e thjeshtë), përveç vendimeve për ndryshimin e Statutit dhe vendimin për shpërbërjen e Shoqatës, të cilat merren me shumicën nga dy të tretat të përfaqësuesve të pranishëm.

Anëtari i cili nuk është në mundësi të merr pjesë në Asamble ka të drejtën e delegimit të votës së vet tek cilido anëtar tjetër i SË BASHKU MË TË FUQISHËM, megjithatë vetëm për pikët e Agjendës për të cilat është informuar paraprakisht. Anëtari që delegon votën e vet duhet patjetër për këtë ta informojë Asamblenë në formën që është përcaktuar nga Bordi Drejtues. Çdo anëtar i pranishëm mund të merr më së shumti 1 votë të deleguar.

Ata përfaqësues në Asamble tek të cilët ekziston konflikti i interesave në lidhje me një vendim të caktuar, do të përjashtohen nga vota gjatë marrjes së atij vendimi.

Në seancat e Asamblesë mund të marrin pjesë dhe qytetarë dhe individë të tjerë, kompetencat e të cilëve lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e Shoqatës, megjithatë, pa të drejtën e votës dhe në përputhje me parimin e besueshmërisë.

### **Neni 22**

#### **- mënyra e votimit në Asamble -**

Me rregull, Asambleja vepron dhe merr vendimet me votë publike, përveç nëse me shumicën e votave të përfaqësuesve të pranishëm nuk vendoset që të zbatohet votimi i fshehtë.

Anëtarët e Asamblesë gjatë votimit kanë mundësi të deklarohen “për” dhe “kundër” dhe “të përmbajtur”. Në rastet kur votohet për përzgjedhjen e një apo më shumë propozimeve, çdo anëtar ka të drejtën që ta japë votën e vet vetëm një herë.

### **Neni 23**

#### **- kompetencat e Asamblesë -**

Asambleja e SË BASHKU MË TË FUQISHËM ka kompetencat e mëposhtme:

- Sjell Statutin dhe aktet e tjera të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe vendos për ndryshimin e tyre;
- shqyrton dhe miraton strategjinë e SË BASHKU MË TË FUQISHËM, programe dhe plane pune vjetore, politikat e Shoqatës, drejtime dhe udhëzime;
- shqyrton dhe miraton raporte vjetore të punës së Shoqatës;
- shqyrton dhe miraton plane dhe raporte vjetore financiare;

- emëron dhe shkarkon Kryetarin e Shoqatës;
- emëron dhe shkarkon Bordin Drejtues të Shoqatës;
- vendos për themelimin dhe pezullimin e degëve dhe formave të tjera të organizimit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- debaton rreth rezultateve të arritura dhe veprimit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe përcakton gjendjen faktike;
- vendos rreth pranimit të anëtarëve të ri dhe pushimit nga anëtarësia në SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- kryen punë të tjera konform ligjit, Statutit dhe akteve të përgjithshme të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- vendos për shpërbërjen e SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

## **VI. KRYETARI**

### **Neni 24**

#### **- mandati i Kryetarit -**

Asambleja zgjedh kryetarin e SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Kryetari ka mandat dy-vjeçar me të drejtë për rizgjedhje.

Në rast të mungesës së Kryetarit ose pamundësisë, detyrimet i merr përsipër një anëtar i Bordit Drejtues që është emëruar nga Kryetari ose Bordi Drejtues për një periudhë të caktuar kohore.

### **Neni 25**

#### **- propozimi dhe zgjedhja e kandidatit për Kryetar -**

Kandidat për Kryetar mund të propozojë çdo anëtar i Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Si i zgjedhur do të konsiderohet ai kandidat i cili ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve në Asamble.

### **Neni 26**

#### **- të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit -**

Kryetari i SË BASHKU MË TË FUQISHËM ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- thirr dhe përgatit seancat e Asamblesë;
- kryeson seancat e Asamblesë;
- nënshkruan dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve, konkluzioneve dhe akteve të tjera të Asamblesë;
- përfaqëson dhe avokon për Shoqatën në qarkullimin juridik me persona të tretë;
- përfaqëson SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- është nënshkruar i xhiro-llogarive të Shoqatës;
- kryeson seancat e Bordit Drejtues dhe nënshkruan vendimet e Bordit Drejtues;

- siguron mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të Asamblesë, Bordit Drejtues dhe trupave dhe organeve të tjera të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- parashtron raportin vjetor për punën e vet përpara Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

### **Neni 27**

#### **- pushimi i funksionit të Kryetarit -**

Funksioni Kryetar i SË BASHKU MË TË FUQISHËM pushon:

- me kërkesë vetjake, dhe
- me propozim të Bordit Drejtues ose me propozim të cilitdo nga anëtarët e Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Propozimi për shkarkimin e Kryetarit duhet të argumentohet në hollësi dhe t'i përmbajë arsyet në bazë të të cilave kërkohet shkarkimi.

Kryetari shkarkohet me vendimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm në Asamble, pas një diskutimi paraprak të hollësishëm në lidhje me arsyetimin dhe arsyet e numëruara në propozimin për shkarkim.

## **VII. BORDI DREJTUES**

### **Neni 28**

#### **- përbërja, zgjedhja dhe mandati i Bordit Drejtues -**

Bordi Drejtues është organ ekzekutiv i Asamblesë, i përbërë nga 3 deri 5 anëtarë.

Anëtarët e Bordit Drejtues i zgjedh Asambleja e SË BASHKU MË TË FUQISHËM me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të pranishëm.

Mandati i anëtarëve është 2 vjet, me të drejtë për rizgjedhje.

### **Neni 29**

#### **- mbajtja e seancave të Bordit Drejtues -**

Seancat e Bordit Drejtues mbahen sipas nevojës, e të paktën katër herë në vit.

Seancat kryesohen nga Kryetari i SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Në seancat e Bordit Drejtues mund të marrin pjesë dhe përfaqësues të donatorëve dhe persona të tjerë që nuk kanë të drejtën e votës, konform parimit të besueshmërisë.

### **Neni 30**

#### **- mënyra e marrjes së vendimeve të Bordit Drejtues -**

Bordi Drejtues mund në mënyrë të plotëvlefshme të punojë dhe të marrë vendime në qoftë se në seancë marrin pjesë të paktën 3 anëtarë.

Bordi Drejtues sjell vendimet e tij publikisht me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast të një vendimi të pazgjidhur, vendimtare është vota e Kryetarit.

Çdo anëtar i Bordit Drejtues ka të drejtën e një vote, përveç Kryetarit, i cili ka të drejtën e votës plotësuese, në rastet kur janë të pranishëm 4 anëtarë dhe ka vendim të pazgjidhur.

Ata anëtarë të Asamblesë tek të cilët ekziston konflikti i interesave në lidhje një vendim të caktuar, do të përjashtohen nga vota gjatë marrjes së atij vendimi.

Bordi Drejtues mban procesverbal për punën e vet, i cili miratohet në seancën e radhës me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Bordi Drejtues në gjendje të jashtëzakonshme mund të sjell vendime edhe me postë elektronike ose me ndonjë lloj tjetër të komunikimit rrjetor.

### **Neni 31**

#### **- kompetencat e Bordit Drejtues -**

Bordi Drejtues është organ i cili autorizohet nga Asambleja për t'i aplikuar gjitha të drejtat e Asamblesë, përveç:

- të sjell vendime për të cilat vendos Asambleja
- të ndërrojë anëtarë të Bordit Drejtues
- të ndryshojë dhe plotësojë Statutin.

Bordi Drejtues kryen punët e mëposhtme:

- propozon thirrjen e seancës së Asamblesë;
- përgatit seanca të Asamblesë dhe propozim-vendime për ato;
- propozon ndryshime dhe plotësime të Statutit;
- propozon Programin Vjetor të Shoqatës përpara Asamblesë;
- propozon Raportin Vjetor dhe Raportin Financiar përpara Asamblesë;
- siguron dhe kryen mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve dhe konkluzioneve të Asamblesë;
- merr pjesë në proceset e krijimit të politikave të Shoqatës;
- kujdeset për zbatimin e qëndrueshëm të strategjisë dhe politikës së Shoqatës;
- merr vendime dhe rregullore për punën e Zyrës Ekzekutive të Shoqatës;
- emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv;
- miraton strukturën organizative të Zyrës Ekzekutive, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv;
- administron dhe përgjigjet për administrimin e pronës së Shoqatës;
- merr vendimin për përfitimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- harton dhe propozon Planin Financiar Vjetor për të ardhurat dhe shpenzimet e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- merr pjesë në hartimin dhe miraton projekte që janë në interes të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- harton planin strategjik, programin e punës dhe akte të tjera me kërkesë të Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- bën inspektimin e punës financiare të SË BASHKU MË TË FUQISHËM; analizon dhe kontrollon raportet financiare të trupave dhe organeve të

- punës të SË BASHKU MË TË FUQISHËM; kontrollon shfrytëzimin dhe menaxhimin qëllimor të fondeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- miraton akte bashkëpunimi me organizata të tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe jashtë saj;
  - merr vendime për kundërshtime, letra lavdërimi dhe letra mirënjohjeje;
  - propozon pranimin dhe përjashtimin nga anëtarësia në SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
  - jep rekomandime tek Asambleja për dhënien e anëtarësisë personave të interesuar që kanë mbushur një fletëparaqitje;
  - propozon dhe zgjedh trupa të tjerë ndihmës dhe komisione pune;
  - thirr seanca (të jashtëzakonshme) të Asamblesë;
  - propozon shkarkimin e Kryetarit të SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
  - sugjeron për parregullsi me të cilat i shkaktohet dëm material SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
  - jep propozime dhe rekomandime tek Asambleja për shkarkimin e parakohshëm të punonjësve në SË BASHKU MË TË FUQISHËM për shkak të punës së papërshtatshme, të paligjshme dhe në kundërshtim me Statutin;
  - themelon bashkëpunim me institucionet publike;
  - vendos për anëtarësimin në aleanca dhe organizata joqeveritare ndërkombëtare;
  - sjell rregulloren e procedurës për punën e vet;
  - parashtron Raportin Vjetor për punën e vet përpara Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

## **VII. ZYRA EKZEKUTIVE**

### **Neni 32**

#### **- formimi dhe kompetencat e Zyrës Ekzekutive -**

Për efikasitet më të madh në punën e vet, SË BASHKU MË TË FUQISHËM ka Zyrën e saj Ekzekutive në varësi nga fondet e siguruar për funksionimin e saj.

Zyra Ekzekutive kujdeset për realizimin e programeve dhe projekteve dhe për kryerjen e punëve administrative dhe të tjera me interes të përbashkët për realizimin e objektivave të SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

Bordi Drejtues përcakton mënyrën e punës dhe kompetencat e Zyrës Ekzekutive.

Zyrën Ekzekutive drejton Drejtori Ekzekutiv.

Anëtarët e Shoqatës që janë punësuar në Zyrën Ekzekutive nuk kanë të drejtën e votës dhe nuk kanë të drejtë të zgjidhen në organet e Shoqatës.

### **Neni 33**

#### **- Drejtori Ekzekutiv -**

Drejtori Ekzekutiv është përfaqësues i Shoqatës në bazë të ligjit.

Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Bordi Drejtues.

Drejtori Ekzekutiv mund të ketë zëvendësin e tij, i cili përkohësisht do t'i kryejë punët dhe detyrat e punës së Drejtorit Ekzekutiv, në rast të mungesës së tij ose pamundësisë për të punuar.

### **Neni 34**

#### **- të drejtat dhe detyrimet e Drejtorit Ekzekutiv -**

Drejtori Ekzekutiv ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- vepron konform objektivave, parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Statutin e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- përfaqëson dhe avokon për Shoqatën në qarkullimin juridik me persona të tretë;
- përfaqëson dhe promovon SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe përfaqëson objektivat dhe interesat e tij përpara subjekteve të jashtme, institucioneve relevante dhe medimeve;
- mban kontakte dhe komunikim të rregullt me anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe zbaton vendimet e marra nga Bordi Drejtues;
- kujdeset për zbatimin e mëkohshëm dhe cilësor të planit/programit të përcaktuar të punës së SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe zbaton detyrimet që dalin nga projektet aktuale, bartës i të cilëve është SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- është nënshkrues i xhiro-llogarive të Shoqatës;
- zbaton politikën, konkluzionet dhe vendimet e marra nga Bordi Drejtues ose nga Asambleja;
- administron Zyrën Ekzekutive;
- e propozon përpara Bordit Drejtues strukturën organizative të Zyrës Ekzekutive;
- i propozon përpara Bordit Drejtues ekipet e punës të cilat do t'i hartojnë dhe zbatojnë projektet dhe programet e Shoqatës dhe ndjek dhe koordinon zbatimin e tyre;
- e informon Bordin Drejtues për rrjedhën e projekteve dhe programeve dhe për financat lidhur me ato;
- të paktën dy herë në vit i dërgon Bordit Drejtues raportin e punës së Zyrës Ekzekutive dhe punës materialo-financiare të Shoqatës;
- është përgjegjës për hartimin dhe parashtrimin e Raportit Vjetor Programor dhe Financiar përpara Bordit Drejtues të Shoqatës;
- koordinon procesin e mbledhjes së fondeve për Shoqatën;
- nënshkruan aktet e bashkëpunimit me organizata të tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe jashtë saj, pas miratimit nga BD ose Asambleja;
- organizon seancat e Bordit Drejtues;
- harton dhe dërgon procesverbalin nga takimet e mbajtura të Bordit Drejtues tek të gjithë anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- administron punët administrativo-operative dhe menaxhon buxhetin në pajtim dhe sipas vendimit të Bordit Drejtues;

- informon anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM për të gjitha takimet e realizuara me institucionet relevante, për takimet me subjekte të jashtme, për komunikimin me mediumet dhe për aktivitete të tjera të ndërmarra që janë të interesit për SË BASHKU MË TË FUQISHËM;
- përcjell çdo njoftim të marrë dhe/ose ftesë për pjesëmarrje në një aktivitet vendas ose ndërkombëtar për të gjithë anëtarët e SË BASHKU MË TË FUQISHËM dhe brenda mundësive financiare në dispozicion kujdeset që të gjithë anëtarët e interesuar të kenë mundësi të barabartë për të marrë pjesë në trajnim, seminar, vizitë studimore, konferencë ose punëtori për avancim profesional në vend ose jashtë vendit;
- paraqet llogaridhënie mbi punën e tij përpara Bordit Drejtues;
- kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë Statut ose me vendim të Bordit Drejtues.

## **IX. MJETET E PUNËS DHE MËNYRA E PËRFITIMIT DHE MENAXHIMIT TË FONDEVE**

### **Neni 35**

#### **- mjetet e punës -**

Për realizimin e objektivave dhe detyrave të veta, SË BASHKU MË TË FUQISHËM përfiton fonde dhe i menaxhon ato në pajtim me Statutin dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 36**

#### **- burimet e fondeve -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM përfiton fonde monetare, sende dhe të drejta (konform një plani afarist të hartuar më herët), të cilat sigurohen me anë të:

- anëtarësisë;
- donacioneve;
- kontributeve vullnetare;
- dhuratave;
- aktiviteteve të organizuara për mbledhjen e fondeve;
- veprimtarive fitimprurëse;
- fondeve nga buxheti i R. së Maqedonisë, buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe buxhetit të Qytetit të Shkupit;
- burimeve të tjera në pajtim me ligjin.

### **Neni 37**

#### **- përfitimi, shfrytëzimi dhe menaxhimi i fondeve -**

Përfitimi, shfrytëzimi dhe menaxhimi i fondeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM bëhet në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe me Statutin.

Për përfitimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e fondeve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM vendos Bordi Drejtues, në pajtim me kompetencat e përcaktuara me Statutin.

## **X. KONTROLLI I PUNËS SË SHOQATËS**

### **Neni 38**

#### **- kontrolli i punës -**

Kontrollin e punës së përgjithshme të SË BASHKU MË TË FUQISHËM e kryen Asambleja.

Kontrollin e punës financiare të Zyrës Ekzekutive të SË BASHKU MË TË FUQISHËM e kryen Bordi Drejtues.

Kontrollin e ligjshmërisë së punës së SË BASHKU MË TË FUQISHËM e kryejnë organet dhe shërbimet kompetente të Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 39**

#### **- iniciativa për përcaktimin dhe mënjanimin e parregullsisë -**

Iniciativë për përcaktimin dhe mënjanimin e parregullsisë në punën dhe aktivitetet e SË BASHKU MË TË FUQISHËM mund të parashtrojë çdo anëtar përpara organeve kompetente të SË BASHKU MË TË FUQISHËM, në pajtim me fushëveprimin e kompetencave të atyre organeve, që janë përcaktuar me Statutin dhe ligjet.

Organi kompetent përpara të cilit është parashtuar iniciativa, detyrohet që të deklarohet me shkrim brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë.

## **XI. SHPËRBËRJA E SHOQATËS**

### **Neni 40**

#### **- shpërbërja e Shoqatës -**

SË BASHKU MË TË FUQISHËM pushon së ekzistuari:

- në rast se është marr vendimi i Asamblesë së SË BASHKU MË TË FUQISHËM me shumicë nga dy të tretash nga të gjithë përfaqësuesit;
- në rast se numri i anëtarëve të SË BASHKU MË TË FUQISHËM bie nën minimumin e përcaktuar me ligj;
- me vendim të gjykatës kompetente;
- në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Neni 41**

#### **- shpërndarja e fondeve pas shpërbërjes së Shoqatës -**

Në rast të shpërbërjes së SË BASHKU MË TË FUQISHËM, prona dhe fondet që mbeten pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve shpërndahen në pajtim me ligjin.



## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 42**

#### **- interpretimi i Statutit -**

Interpretimin e dispozitave të këtij Statuti e ofron Asambleja e SË BASHKU MË TË FUQISHËM, e ndërmjet dy seancave të saj - Bordi Drejtues.

### **Neni 43**

#### **- hyrja në fuqi e Statutit -**

Statuti hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Asambleja Themeltare e SË BASHKU MË TË FUQISHËM.

30 tetor 2017  
Shkup

Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që jetojnë me  
HIV - SË BASHKU MË TË FUQISHËM Shkup  
Kryetari,  
Kire Bllagoeski